



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 157, datë 24.07.2019

**PËR
REVOKIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË SË BROKERIMIT NË SIGURIME
“SMART INSURANCE BROKER” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pikës 2), pikës 21) dhe pikës 22), të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 211, pika 4, germet c), ç) dhe e) dhe nenit 7, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E :

Shoqëria e brokerimit në sigurime në klasat e Jo-Jetës “Smart Insurance Broker” sh.a., është licencuar nga Autoriteti me licencë nr. 20, datë 30.03.2017.

Ndaj kësaj shoqërie është marrë Vendimi i Bordit nr. 66, datë 27.03.2019, sipas të cilit shoqëria “Smart Insurance Broker”sh.a., nuk ka zbatuar përkatësisht:

- Të plotësonte kapitalin bazë të paguar në para, sipas kërkesave të pikës 1/a) të nenit 211, të Ligjit 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”. Kjo kërkesë nuk është zbatuar;
- Të ketë të paktën një broker të punësuar me kohë të plotë sipas kërkesave të pikës 1/b) të nenit 211, të Ligjit 52/2014. Aktualisht shoqëria e brokerimi nuk ka broker fizik të punësuar dhe në QKB rezulton me status të “pezulluar” pa afat;
- Sipas pikës 2 të vendimit nr. 66, datë 27.03.2019, në rast të mosplotësimit të kërkesave ligjore pas afatit të përcaktuar në këtë vendim, shoqërisë së brokerimit “Smart Insurance Broker”sh.a. do t’i revokohet licenca.

Për sa më sipër Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Revokimin e licencës nr. 20, datë 30.03.2017, së shoqërisë së brokerimit “Smart Insurance Broker” sh.a.
2. Shpalljen e licencës të pavlefshme bazuar në pikën 7, të nenit 211, të Ligjit 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.
3. Ngarkohen Departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR

Deniz DERALLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin KOÇI